



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 21.3.2023

Nr: 185

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

LIRIM DHE EMËRIM TË DISA ANËTARËVE DHE SEKRETARËVE TË KZAZ-VE NR. 07, BASHKIA

PUKË, NR. 36 BASHKIA TIRANË, DHE NR. 60 BASHKIA PATOS

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, janë kërkuar zëvendësime të anëtarëve në KZAZ-të si më poshtë:

Partia e Lirisë, me shkresën nr. 1798 prot., datë 21.03.2023, ka kërkuar zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.07, Bashkia Pukë.

Partia Demokratike e Shqipërisë, me shkresën nr. 468/2 prot., datë 13.03.2023, ka kërkuar lirimin nga detyra e pozicionit të anëtarit dhe emërimin e tij në pozicionin e sekretarit të KZAZ-së nr. 36, Bashkia Tiranë dhe lirimin nga pozicioni i sekretarit dhe emërimin e tij anëtar në KZAZ nr. 60, Bashkia Patos.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Data: 21.3.2023 Nr: 185
Ora: 12:00



“Për lirim dhe emërim të disa anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve nr. 07, Bashkia Pukë, nr. 36 Bashkia Tiranë, dhe nr. 60 Bashkia Patos”

V E N D O S:

1. Lirimin nga detyra të anëtarit të KZAZ-së nr. 07, z. Elidon Nikolin Pjetri, Bashkia Pukë, lirimin nga pozicioni i anëtarit të KZAZ-së nr. 36, z. Erenik Sejdi Peka, Bashkia Tiranë, si dhe lirimin nga pozicioni i sekretarit të KZAZ nr. 60 z. Xhevahir Myrtaj, Bashkia Patos.
2. Emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 07, z. Fatos Kadri Sylja, Bashkia Pukë, emërimin në pozicionin e sekretarit të KZAZ-së nr. 36 z. Erenik Sejdi Peka, Bashkia Tiranë dhe emërimin e z. Xhevahir Myrtaj në pozicionin e anëtarit të KZAZ nr. 60, Bashkia Patos.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI